REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01 - 573/2
Data/Datum/Date: 23 / 10 /2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Drejtësisë / MinistarsvoPravde / Ministry of Justice

Kabineti i Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë - Ured Zamenica Premijera i Ministarke Pravde - Cabinet of the Deputy Prime Minister and Minister of Justice

Nr.259/26

Datë:23/10/2026

Duke u mbështetur në nenet 9, 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 15 dhe 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 65 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 11 të Rregullores nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M
për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil për interes të institucionit

1. Z. Ridvan Hoti, i transferuar përkohësisht në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm, për interes të institucionit transferohet përhershëm brenda së njëjtës kategori të shërbimit civil, në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri të Drejtësisë.

2. Transferimi sipas pikës 1 të këtij Vendimi bëhet për periudhën e mbetur të mandatit, për të cilin nëpunësi është emëruar në kategorinë e lartë drejtuese, në pajtim me nenin 65 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

3. Divizioni për Burime Njerëzore dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa obligohen që të ndërmarrin të gjitha veprimet për zbatimin e këtij Vendimi dhe pagesën e nëpunësit sipas pagës së pozitës në të cilin është transferuar.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Duke zbatuar legjislacionin përkatës në fuqi dhe në përputhje me Programin Legjislativ, planet e tjera të punës dhe objektivat e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe për shkak të domosdoshmërisë së plotësimit të pozitës dhe në interes të institucionit, është vlerësuar dhe është vendosur transferimi i përhershëm i nëpunësit civil z. Ridvan Hoti, brenda së njëjtës kategori të shërbimit civil, duke llogaritur kohën e kaluar përgjatë mandatit të tij të filluar nga transferimi i përkohshëm.

Gjatë periudhës gjashtëmujore të ushtrimit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, është vlerësuar se përvoja e z. Ridvan Hoti, njohja e proceseve të brendshme dhe vazhdimësia në menaxhimin e administratës së Ministrisë janë të rëndësishme për realizimin me efikasitet të objektivave institucionale.

Në veçanti, vazhdimësia në ushtrimin e kësaj detyre vlerësohet e nevojshme për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga Plani i Rritjes dhe dokumentet e tjera relevante, zbatimin e Programit Legjislativ, avancimin e proceseve të digjitalizimit dhe realizimin e prioriteteve të tjera strategjike dhe operative të Ministrisë së Drejtësisë.

Për këto arsye është vlerësuar se transferimi i përhershëm është në interes të institucionit. Andaj, mbi bazën e kësaj, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe pas marrjes së pëlqimit nga nëpunësi civil, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Donika Gërvalla - Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:

- *Z. Ridvan Hoti;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*